



NGROHTORJA E QYTETIT SH.A. GJAKOVË
DICTRICT HEATING J.S.C. GJAKOVA

Adresa: "Behije Dashi" Rezinë, Gjakovë
Tel & Fax: (0390) 326 657
Mob: +383 (0) 46 127 066

NUI: 811326471
info@ngrohtorja.org
www.ngrohtorja.org

BILANCI VJETOR I ENERGJISË TERMIKE
Për vitin 2025

PËRMBAJTJA

HYRJE	2
AKTIVITETI.....	2
HISTORIKU	3
PËRSHKRIMI I KAPACITETEVE PËR PRODHIMIN E ENERGJISË TERMIKE.....	4
PËRSHKRIMI I RRJETIT TË SHPËRNDARJES	6
VIZIONI PËR ZHVILLIMIN E SISTEMIT TË ENERGJISË TERMIKE	8
PARASHIKIMI I KËRKESËS PËR ENERGJI TERMIKE	10
DETAJE PËR PARASHIKIMIN VJETOR TË KËRKESËS	10
PARASHIKIMI I HUMBJEVE NË RRJET	11
PARASHIKIMI I PRODHIMIT TË ENERGJISË TERMIKE	12
PLANIFIKIMI I REMONTEVE DHE RIPARIMEVE.....	13
EMETIMET E PARASHIKUARA PËR VITIN AKTUAL	13

Hyrje

Bilanci vjetor për 2025 i Energjisë Termike për N.P. Ngrohtorja e Qytetit SH.A. Gjakovë, është përgatitur duke u bazuar në Ligjin Nr. 05/L-081 për Energjinë (neni 8) dhe Rregullën dhe Metodologjinë për Hartimin e Bilanceve të Energjisë të Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE-së).

Ky dokument paraqet planifikimin njëvjeçar (sezonal) të kërkesës për energji termike dhe parashikimet për gjenerimin e nevojshëm të energjisë termike, si dhe parashikimet për humbjet në prodhim dhe në rrjetin e shpërndarjes.

Parashikimi i të dhënave në këtë bilanc është bazuar në të dhënat historike, planet zhvillimore aktuale, dhe në studimet dhe strategjitë përkatëse sektoriale. Sidomos parashikimet janë të bazuara në Studimet dhe dokumentet e projektit për Ngrohtoren e Re dhe njësinë e ko - gjenerimit të NQ Gjakova.

Aktiviteti

Duke pasur parasysh gjendjen në N.P. Ngrohtorja e Qytetit SH.A. në Gjakovë, ofrimi i ngrohjes gjatë sezonit dimëror vit pas viti është mundësuar duke ju falënderuar subvencioneve të ndara nga Qeveria e Republikës së Kosovës, përkatësisht Ministria e Ekonomisë.

Sezoni 2024/2025 për Ngrohtoren e Qytetit është sezoni i katërt i funksionimit të Impiantit të Ri me Biomassë. Ky Impiant është finalizuar dhe është lëshuar në punë zyrtarisht në Korrik 2021. Realizimi i këtij projekti ka mundësuar që në të ofrohet furnizim i pandërprerë dhe kualitativ.

Në këtë drejtim, N.P. Ngrohtorja e Qytetit SH.A. në Gjakovë përpiqet t'i harmonizojë veprimet dhe aktivitetet e veta, gjithnjë me qëllim të vazhdimit të operimit dhe ofrimit të ngrohjes cilësore për konsumatorët aktualë të paktën për pjesën jugore dhe atë veriore që është sanuar plotësisht, gjegjësisht sipas projektit "Përmirësimi i performancës së Ngrohtores së Qytetit në Gjakovë" – financuar nga SECO Zvicerane dhe KK Gjakovë – komponenti 2. Përmirësimi i efijencën së energjisë në rrjetin e NQ.

Historiku

Ngrohtorja e Qytetit është themeluar në vitin 1981 dhe nga janari i vitit 2006 është shndërruar në shoqëri aksionare. Është regjistruar në Regjistrin e Bizneseve të Kosovës në vitin 2005 dhe administrohej nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM). Që nga qershori i vitit 2009, ndërmarrja është në pronësi dhe nën mbikëqyrje të Komunës së Gjakovës në përputhje me Ligjin “për Ndërmarrjet Publike”.

Ndërmarrja filloi veprimtarinë në vitin 1982 dhe ishte projektuar për të operuar me mazut dhe për furnizim me ngrohje për konsumatorët e amvisërisë rreth 100,000 m², NVM - 12 000 m² dhe sektorin publik - 80,000 m². Ish impianti i prodhimit të ngrohjes ishte i pajisur me dy kaldaja gjithsej 38 MW me mazut, dhe sistemi i shpërndarjes kishte gypa në gjatësi prej 27 km dhe 302 nënstacione (nga të cilat 10 nënstacione në sektorin komercial, 45 nënstacione në ndërtesa kolektive banimi dhe 247 nënstacione në shtëpi individuale).

Që nga mesi i viteve 1990, operacionet e Kompanisë pësuan një rënie të konsiderueshme me ndikim të drejtpërdrejtë në profit dhe në likuiditetin e saj për arsyt e mëposhtme:

- Mungesa e kontrolluesve dhe mungesa e njehsorëve të ngrohjes dhe/ose alokuesve të kostos së ngrohjes në ambientet e konsumatorëve çojnë në humbje të energjisë dhe nuk mundësonin faturimin e bazuar në konsum;
- Përveç kësaj, impianti ishte projektuar për të funksionuar me mazut dhe çmimi i lëndës djegëse është rritur ndjeshëm gjatë asaj periudhe dhe funksionimi i impiantit është bërë joekonomik; dhe
- Tarifat e ngrohjes nuk mbulonin kostot dhe mbaheshin ndjeshëm nën shkallën e inflacionit.

Për sa u tha më sipër, ndërmarrja nuk ishte në gjendje të siguronte furnizim të besueshëm dhe të vazhdueshëm me ngrohje për konsumatorët e saj (ngrohja furnizohej vetëm për 4-6 orë në ditë). Për të vazhduar obligimet e saj për ngrohje, ndërmarrja mernte subvencione nga Qeveria e Kosovës për mazut (500,000 euro për çdo sezon të ngrohjes), por ky subvencion nuk ishte i mjaftueshëm për të blerë sasi të nevojshme për ta mbuluar kërkesën për ngrohje gjatë gjithë sezonit të ngrohjes. Si rezultat, Ngrohtorja e Qytetit operonte me humbje financiare dhe detyrimet e akumuluar rrjedhëse ishin rritur në shuma të konsiderueshme. Prandaj, kërkohej që urgjentisht ndërmarrja të nisë me kursime të menjëhershme të kostos dhe me rritje të të ardhurave.

Në vitin 2017, BE me Instrumentin e saj për Asistencën e Para-Anëtarësimit (IPA-II) financoi 14 milionë euro për përmirësimin e sistemit të 'NQ të Gjakovës' duke kaluar në një impiant të kombinuar të kogjenerimit të energjisë termike dhe elektrike të bazuar në biomasë. Në

sezonën 2021/2022, impianti i ri i kogjenerimit filloi funksionimin duke ofruar ngrohje për qytetin e Gjakovës duke përdorur vetëm kaldaja për ngrohje.

Në vitin 2020, SECO financoi dhe inicoi projektin “Përmirësimi i Performancës së Ngrohjes Qendrore në Gjakovë”. Projekti u fokusua në mbështetjen e Ndërmarrjes NQ në drejtim të ngritjes së kapaciteteve (kapacitetet operative, financiare dhe administrative) dhe në përmirësimin e efikasitetit energjetik të sistemit të ngrohjes qendrore, p.sh., rehabilitimin e degës veriore dhe ndërhyrjet/riparimet në disa pjesë të degës së jugut; gjithashtu, renovimi i nënstacioneve dhe instalimi i njehsorëve.

Ndërmarrja do të funksionojë në bazë të ligjeve në fuqi, akteve nënligjore, akteve tjera normative dhe standardeve të kontabilitetit dhe është e regjistruar në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) me numrin e regjistrimit të biznesit (NUI) 811326471 më 02 Korrik 2019.

Përshkrimi i Kapaciteteve për Prodhimin e Energjisë Termike

Impianti i biomasës është vënë në punë në fillim të vitit 2021 dhe përbehet nga:

- Dy njësi vetëm për prodhimin e energjisë termike (kaldaja vetëm për ngrohje) me kapacitet të instaluar 2 x 5.5 MWTH , përkatësisht 11 MWTH , dhe
- Një njësi kogjenerimi me kapacitet të prodhimit të energjisë termike prej 4 MWTH dhe Një kapaciteti prodhues të energjisë elektrike 1.12 MWEL.

Përveç kësaj, brenda impiantit janë instaluar 2x250 m³ rezervuarë për ruajtjen e nxehtësisë, me kapacitet total të vlerësuar prej 3MWth dhe ngarkesë termike prej 12 MWth. Këta rezervuarë janë projektuar për të mbuluar kërkesat maksimale dhe do të ofrojnë kushte optimale për prodhimin e nxehtësisë duke ofruar fleksibilitet për të përmbushur kërkesat e luhatshme. Kaldajat e impiantit janë projektuar për të funksionuar me lëndë djegëse të biomasës së drurit – kryesisht copëza druri.

Tabela 1. Karakteristikat teknike të njësive

Njësia prodhuese	Viti i lëshimit në punë	Kapaciteti i instaluar termik (MW)	Kapaciteti termik në dispozicion (MW)	Efikasiteti termik (%)	Lloji i lëndës djegëse
Njësia 1 CHP	2021	4.0 (TH); 1.1 (EL);	3.4 (TH); 1.1 (EL);	70 (TH); 15 (EL);	Biomassë
Njësia 2 HOB	2021	5.5	4.67	85	Biomassë
Njësia 3 HOB	2021	5.5	4.67	85	Biomassë
Total		15 (TH); 1.1 (EL);	13.5 (TH); 1.1 (EL);	80 (TH); 15 (EL);	

Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur të dhënat për prodhimin e energjisë termike.

Tabela 2. Prodhimi i energjisë termike në impiantin e tri sezonet e fundit

Muaj	Konsumi i Biomassës [t]	Vlera kalorike [MWh/ton]	Energjia në karburant/ lëndë djegëse [MWh]	Eficienca termike [%]	Prodhimi bruto [MWh]
2021/22 ¹ (141 ditë)	5,996.12	2.24	13,431.30	85	11,417.00
2022/23 ² (113 ditë)	6,227.69	2.22	13,825.47	85	11,752.00
2023/24 ³ (145 ditë)	8,125.12	2.42	19,662.80	85	16,713.37

Një krahasim përmbledhës mes tri sezoneve të fundit paraqitet më poshtë:

Sezoni 2021-2022			
<i>Muaji</i>	<i>Ditë</i>	<i>Energjia e prodhuar nga kaldajat [MWh]</i>	<i>Biomasa [t]</i>
Tetor	11	542.28	284.78
Nëntor	30	1,978.64	1,039.2
Dhjetor	31	3,120.98	1,639.15
Janar	31	2,972.21	1,560.98
Shkurt	28	2,054.98	1,079.29
Mars	10	747.85	392.72
Total	141	11,417.00	5,996.12

Sezoni 2022-2023			
<i>Muaji</i>	<i>Ditë</i>	<i>Energjia e prodhuar nga kaldajat [MWh]</i>	<i>Biomasa [t]</i>
Nëntor	23	1,640.78	869.47
Dhjetor	31	3,676.37	1,948.22
Janar	31	3,744.54	1,984.34
Shkurt	28	2,690.31	1,425.66
Total	113	11,752.00	6,227.69

Sezoni 2023-2024			
<i>Muaji</i>	<i>Ditë</i>	<i>Energjia e prodhuar nga kaldajat [MWh]</i>	<i>Biomasa [t]</i>
Nëntor	23	2,293.45	1,114.95
Dhjetor	31	3,632.00	1,765.68
Janar	31	4,183.94	2,034
Shkurt	29	3,455.62	1,679.93
Marsi	31	3,148.36	1,530.56
Total	145	16,713.37	8,125.12

1 Kohë zgjatja e operimit nga 23 Tetor 2021 - 10 Mars 2022

2 Kohë zgjatja e operimit nga 7 Nëntor 2022 - 28 Shkurt 2023

3 Kohë zgjatja e operimit nga 6 Nëntor 2023 - 1 Prill 2024

Përshkrimi i Rrjetit të Shpërndarjes

Rrjeti i shpërndarjes i N.P. Ngrohtorja e Qytetit' SH.A. në Gjakovë ndahet në dy degëzime kryesore: degëzimi i pjesës veriore të qytetit dhe degëzimi i pjesës jugore.

Tabela 3. Karakteristikat e rrjetit të shpërndarjes

	Rrjeta veriore e sanuar	Rrjeta jugore
Orientimi	Pjesa veriore	Pjesa jugore
Drejtimi	Nga SH.F. Zekeria Rexha	Nga Spitali i Qytetit
Viti i fillimit të shtrirjes së rrjetit	2022	2001
Lloji i rrjetit	Gypa të para izoluar	Gypa të para izoluar

Rrjeti primar i shpërndarjes ka gypa në gjatësi prej rreth 47.04 km dhe ndahet në dy degë: dega veriore dhe dega jugore.

Pjesa e vjetër e rrjetit, shtrihet nga Ngrohtorja e vjetër, shkon drejt pjesës veriore të qytetit dhe arrin në shkollën fillore “Zekeria Rexha”. Në këtë pjesë të rrjetit, të themeluar në vitin 1980, janë të lidhura kryesisht institucionet si: shkollat, qendrat shëndetësore, Kuvendi i Komunës, Shtëpia i Kulturës dhe ndërtesat kolektive. Kjo pjesë e rrjetit ka një gjatësi prej 8.60 km (8.60 km x 2 tuba = 17.21km gjatesi gypi), e cila përfshinë dy tuba uji. Tubat janë tuba të zinj të izoluar melesh mineral dhe të mbështjellë me letër ‘ter’ të vendosura në kanalin e betonit.

Pjesa e re e rrjetit shkon drejt pjesës jugore të qytetit dhe arrin në Spitalin Rajonal “Isa Grezda”, i cili gjithashtu furnizohet me ngrohje. Kjo pjesë e rrjetit ka qenë donacion nga SIDA, një organizatë suedeze, e themeluar në vitin 2001 dhe qëllimi kryesor ishte të mundësonte lidhjen e spitalit me rrjetin primar termik. Pjesa jugore e rrjetit përfshinë një gjatësi prej 14.91 km (14.91 km x 2 tuba = 29.83 km gjatesi gypi) të trasesë, në të cilën janë vendosur dy gypa të paraizoluar. Në këtë pjesë të rrjetit ka një kombinim pak më të ndryshëm të klientëve të lidhur në rrjet, krahasuar me pjesën veriore të rrjetit. Përveç institucioneve dhe disa ndërtesave kolektive, struktura e klientëve, sipas numrit të tyre, dominohet nga shtëpitë individuale, të cilat përbëjnë një pjesë të çmueshme të bazës së klientëve të Ndërmarrjes.

Furnizimi i konsumatorëve me energji termike bëhet përmes shkëmbyesve të energjisë të cilët janë të vendosur në nënstacione dhe bëjnë kalimin e energjisë nga rrjeti primar në rrjetin dytësor. Sistemi i rrjetit është indirekt (me shkëmbyes nxehtësie) Rrjeti dytësor është pjesë e përgjegjësisë së klientëve dhe për rrjedhojë ndërmarrja është përgjegjëse për shpërndarjen e energjisë deri te shkëmbyesi.

Pasi që tashme rrjeti verior dhe ai Jugor tashmë ndahen tek puseta kryesore të sigurimit (semaforët) e jo si në të kaluarën nga Ngrohtorja e vjetër dhe duke marr parasysh kyçjet e reja, atëherë numri i nënstacioneve është kështu: Veriu=90 nënstacione, Jugu=300 nënstacione, pra total kemi 390 nënstacione.

Tabela 4. Karakteristikat teknike të rrjetit të shpërndarjes

	Dega Veriore	Dega Jugore	Total
Viti i Ndërtimit	2021/2022	2001	
Gjatësia	17.21 km	29.83 km	47.04 km
Lloji i rrjetit	Para-izoluar	Para-izoluar	
Kapaciteti termik	20 MW	20 MW	40 MW
Kapaciteti i vëllimit	600 m ³ bashkë me DN350	446 m ³	1046 m ³
Numri i nënstacioneve	90	300	390

Në vijim paraqitet harta e shtrirjes së rrjetit të shpërndarjes së NQ Gjakova.



Figura 1. Harta e rrjetit të shpërndarjes

Vizioni për Zhvillimin e Sistemit të Energjisë Termike

Planet afatgjatë të ndërmarrjes për prodhimin e energjisë termike N.P. “Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë” Sh.A. i bazon në projektin e tanishëm impiantin e ri, ashtu quajtur Ngrohtorja e Re. Ky projekt do të ketë ndikim në krijimin e një burimi të sigurt, ekonomikisht të favorshëm dhe të përshtatshëm në kuptim të mbrojtjes së ambientit.

Si aktivitete pasuese të projektit për ngrohtoren e re, në vitet e ardhshme priten investime të konsiderueshme në rehabilitimin e rrjetit të ngrohjes, për rehabilitimin dhe zgjerimin e rrjetit, që do të rezultojnë në zgjerimin e bazës së konsumatorëve përkatësisht rritjen e sipërfaqes ngrohëse të kyçur në sistemin e ngrohjes qendrore të N.P. “Ngrohtorja e Qytetit Gjakovë” Sh.A.

- Funksionimi i njësive CHP

Njësia CHP do të nisë funksionimin gjatë sezonit të ngrohjes 2024/2025, duke gjeneruar të ardhura shtesë për Kompaninë nga shitja e energjisë elektrike. Duke qenë se njësia pret të fillojë punën në 01 Dhjetor 2024, prodhimi i energjisë elektrike vlerësohet për gjatë një muaji operimi të jetë 806.4 MWh ($1.12 \times 24 \times 30$), ndërsa po të arrihej komplet sezonin me operua vlerësohet në 4865 MWh.

- Rikthimi i konsumatorëve pasiv

Gjatë vitit 2025, ndër objektivat kryesore është edhe rikthimi i konsumatorëve pasiv të cilët ka vite që nuk marrin shërbim. Këta konsumatorë janë në objektet e vjetra kolektive dhe rrjeti sekondar i këtyre objekteve është i dëmtuar për shkak të vjetërsisë ose edhe dëmtimet të pariparueshme të cilat janë bërë gjatë renovimit të njësive banuese. NQ planifikon që nga viti 2025 të fillojë investimin në këto objekte të cilat kanë sistemin sekondar vertikal të dëmtuar të kalojmë në rrjet të ri të furnizimit me sistem kasetorë dhe të ju bëhet e mundur secilës njësi banuese të kyçet në korridor në katin përkatës.

Kjo fazë do të fillojë me ato objekte të cilat nënstationet dhe rrjetin primar e kanë funksional. Investimi do të fillojë të bëhet nga Ngrohtorja, dhe njëkohësisht do të shohim edhe mundësi të bashkë investimit me Komunën ose donator tjerë.

- Zgjerimi i bazës së konsumatorëve – zgjerimi i zonës së shërbimit të furnizimit

Gjatë periudhës së ngrohjes 2024/2025, sipërfaqja e ngrohjes pritet të rritet 18,450 metra katrorë për arsyet e mëposhtme.

Lidhje të reja në rrjetin e ngrohjes qendrore të disa ndërtesave publike (shih tabelën më poshtë), të cilat ndodhen në zonën ekzistuese të furnizimit. Lidhja e tyre me rrjetin e

shpërndarjes me shtimin e një seksioni të shkurtër tubacioni, tubacionet e shërbimit dhe nënstacionet përkatëse të ngrohjes u financuan nga SECO.

Tabela 5. Lista e Ndërtesave Publike të kyçura në vitin 2024

Institucionet	m²
Gjykata	4,400
Kuvendi Komunal-Objekti ri	11,000
Administrata Tatimore e Kosovës	2,000
Qendra e shëndetit Mendor	550
Qendra për punë sociale	500
GJITHSEJ	18,450 m²

Nder këto objekte shërbim veq kanë filluar të marrin këtë muaj si Gjykata, Administrata taimore, qendra e shëndetit mendor, qendra sociale, përveq Kuvendit të ri komunal pasi ende nuk kanë kaluar zhvendosjen dhe punën në objektin e ri.

Riaktivizimi gradual i konsumatorëve pasivë dhe zgjerimi i rrjetit të shpërndarjes së energjisë termike në zona të reja të shërbimit, që janë afër asaj ekzistuese parashihet sipas tabelës me poshtë:

Tabela 6. Lista e Objekteve të planifikuara potenciale për kyçe në vitin 2025

Objekte të banimit kolektiv	m²
Letaj Home – HOTEL (Tranzit – përball Ngro. Vjetër)	2500
Arian Shehu – HOTEL (Rr. Migjeni)	1200
Banesa G. Binishi (Rr. Migjeni)	700
Banesa Qerimi 1&2 (afër shkollës Z. Rexha)	4000
Banesa Egzoni-D (Tranzit, pas konviktit)	6000
Banesa Ahmeti Construction (Tranzit, pas konviktit)	7000
Banesa Ahmeti Construction (Rr. E. Stavileci)	5500
GJITHSEJ	26,900m²

- Fushata informative për sistemin e faturimit të bazuar në konsum dhe njehsorët e nxehtësisë

Për shkak se ndryshimi në sistemin e ri të faturimit nga ai mëparshëm, d.m.th. në bazë të metrave katror, mund të krijojë konfuzion të mundshëm në sjelljen e konsumatorit, ndërmarra ka zhvilluar një fushatë ndërgjegjësimi, përmes takimeve direkt me konsumatorët përmes mediave të informimit por edhe përmes test faturave të dërguara tek konsumatorët. Kjo fushatë ka përfshirë edhe informata për konsumatorët se si duhet të funksionojë sistemi i njehsorëve, për përdorim më efikas në sistemin e tyre të ngrohjes (valvolat termostatike të radiatorit). Për më tepër, duke qenë se ndërtesat me shumë apartamente përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të ndërtesave të furnizuara nga ngrohja qendrore, fushata ka përfshirë edhe informata për veçoritë specifike të instalimeve të brendshme të ngrohjes që matin

konsumin aktual të nxehtësisë dhe për këtë arsye mund të aplikohet faturimi i bazuar në konsum në nivelin e apartamentit (ndarësit e kostos së ngrohjes).

Gjatë vitit 2024, kompania ka përpunuar planin e ndërgjegjësimit i cili do të përfshijë të gjithë hapat dhe veprimet e nevojshme për zbatimin e faturimit të bazuar në konsum. Gjithashtu gjatë muajve maj, qershor dhe korrik menjëherë pas përfundimit të sezonës ngrohëse 2023/2024, është bërë edhe procesimi i test faturave posaçërisht për shtëpi dhe institucione duke u bazuar në matje me konsum, të cilat janë dërguar tek konsumatorët si njoftim i cili do të ndikoj në ndërgjegjësimin e kursimit të energjisë për sezonën që vjen.

Parashikimi i Kërkesës për Energji Termike

Metodologjia

Metodologjia e përdorur për parashikimin e kërkesës për ngrohje është bazuar në të dhënat historike të konsumit të ngrohjes, karakteristikat e sistemit të ngrohjes qendrore në kuptim të mundësisë për zgjerimin e rrjetit e rrjedhimisht të bazës së konsumatorëve, si dhe të kapaciteteve prodhuese të energjisë termike. Gjithashtu në parashikimin e kërkesës janë marrë për bazë projeksionet zhvillimore të Ngrohtorja e Qytetit, Gjakovë.

Projeksionet zhvillimore të sistemit të ngrohjes qendrore të NQ Gjakova për prodhimin të energjisë termike kryesisht i bazon në projektin e tanishëm të ngrohtores së re, që përfshinë njësinë e ko - gjenerimit me lëndën djegëse biomasë. Po ashtu projeksionet zhvillimore përfshijnë planifikimet për rehabilitim të rrjetit ekzistues dhe për zgjerim të rrjetit të shpërndarjes. Kjo do të ndikoj në rikthimin e konsumatorëve (aktualisht “pasiv”) dhe në rritjen e bazës së konsumatorëve, e rrjedhimisht ndikon në rritjen e sipërfaqes ngrohëse, që janë faktorë përcaktues për rritjen e konsumit të ngrohjes.

Detaje për Parashikimin Vjetor të Kërkesës

Për parashikimin e kërkesës / konsumit, një komponent e rëndësishme është shfrytëzimi i të dhënave për konsumin në sezonin e kaluar. Kështu për vitin 2025 planifikojmë rreth 25,745 m². Pra gjatë vitit 2025 do të vazhdohet të operohet deri në fund të sezonës, përkatësisht deri në Prill, 2025 duke planifikuar fillimin e operimit të njësisë së kogjenerimit. Në tabelën vijuese është paraqitur planifikimi vjetor i kërkesës dhe furnizimit me energji termike.

Tabela 7. Zgjerimi i planifikuar i sipërfaqes ngrohëse në vitin 2025

Viti	Sip. Ngroh. aktuale [m ²]	Zgjerimi i Sip. Ngroh. [m ²]	Sip. Ngroh. Totale e kyqur [m ²]
2024	144,600	25,745	170,345

Duhet të theksohet se ka pritshmëri që gjatë 2025 me ofrimin e furnizimit me ngrohje gjatë gjithë sezonit të ngrohjes, numri i konsumatorëve gradualisht do të riaktivizohet.

Në tabelën vijuese është paraqitur planifikimi vjetor i kërkesës dhe furnizimit me energji termike.

Tabela 8. Parashikimi i furnizimit / kërkesës për energji termike

KËRKESA E KONSUMATORËVE PËR ENERGJI TERMIKE – VITI 2025									
	Konsumatorët Shtëpiak			Konsumatorët Komercial e Institucional			Total Konsumatorët		
	Sip. Ngroh. (m ²)	Kapac. Term. (MW)	Sasia e en. term. (MWh)	Sip. Ngroh. (m ²)	Kapac. Term. (MW)	Sasia e en. term. (MWh)	Sip. Ngroh. (m ²)	Kapac. Term. (MW)	Sasia e en. term. (MWh)
Janar	49,500	4.46	1,081	95,100	9.51	2,103	144,600	13.97	3,184
Shkurt	51,175	4.61	956	97,650	9.77	2,072	148,825	14.37	3,028
Mars	51,850	4.67	875	97,650	9.77	1,898	149,500	14.43	2,773
Prill	52,100	4.69	565	97,650	9.77	1,110	149,750	14.45	1,675
Tetor	60,650	5.46	678	104,850	10.49	1,251	165,500	15.94	1,929
Nëntor	63,450	5.71	1,016	105,630	10.56	2,360	169,080	16.27	3,376
Dhjetor	64,715	5.82	1,163	105,630	10.56	2,445	170,345	16.39	3,608
Total / Mes. *	56,206	5.06	6,334	100,594	10.06	13,239	156,800	15.12	19,573

Në tabelën më poshtë paraqitet kërkesa e planifikuar për energji termike përfshirë edhe humbjet në rrjet.

Tabela 9. Parashikimi i kërkesës për energji termike plus humbjet në rrjet për sezonin 2025

KËRKESA PËR ENERGJI TERMIKE (KËRKESA E KONSUMATORËVE PLUS HUMBJET NË RRJET) – VITI 2025								
Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total
Kërkesa e konsumatorëve për energji termike (MWh)	3,028	2,660	2,671	2,585	2,675	2,948	3,007	19,573
Total humbjet sasiore në rrjetin e shpërndar. (MWh)	694	554	494	185	155	627	746	3,454
Total kërkesa e kons. plus humbjet (MWh)	3,722	3,214	3,165	2,770	2,829	3,575	3,753	23,027

Parashikimi i Humbjeve në Rrjet

Përgjatë vitit 2025 humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes janë vlerësuar rreth 15% që paraqet një nivel më të ultë të humbjeve pas riparimeve të vazhdueshme që janë bërë në pjesën jugore. Në vitin/sezonin vijues parashihen vazhdimisht disa riparime dhe rehabilitime emergjente që do të ndodhin me ndikim në zvogëlimin e nivelit të humbjeve në rrjetin primar të termofikimit por edhe sekondar të pjesës jugore.

Tabela 10. Parashikimi i humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2025

HUMBJET NË RRJET - VITI 2025								
Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total/ Mesatare
Humbjet sasiore në rrjetin e transportimit (nëse është e aplikueshme) (MWh)	0	0	0	0	0	0	0	0
Humbjet në përqindje në rrjetin e transportimit (%)	0	0	0	0	0	0	0	0
Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes (MWh)	694	554	494	185	155	627	746	3,454
Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes (%)	15%	15%	15%	15%	15%	15%	15%	15%
Total humbjet sasiore në rrjet (MWh)	694	554	494	185	155	627	746	3,454
Total humbjet në rrjet në përqindje (%)	15%	15%	15%	15%	15%	15%	15%	15%

Parashikimi i Prodhimit të Energjisë Termike

Për parashikimin e prodhimit të energjisë termike jemi bazuar rrjedhimisht në prodhim të plotë deri në fund të vitit/sezonës. Planifikimet për prodhimin e energjisë termike përgjithësisht janë vlerësuar për të mbuluar kërkesën e parashikuar për energji termike (konsumin).

Në tabelën më poshtë janë paraqitur prodhimi bruto dhe neto i energjisë termike, sipas muajve për vitin 2024.

Tabela 11. Parashikimi i prodhimit bruto dhe neto të energjisë termike për vitin 2025

PRODHIMI I ENERGJISË TERMIKE - viti 2025								
Përshkrimi/Muaji	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Total/Mesatare
Energjia nga lënda djegëse (MWh)	5,457	4,360	3,884	1,453	1,216	4,929	5,862	27,161
Efikasiteti termik i stabilimenteve prodhuese në Ngrohtore (%)	85%	85%	85%	85%	85%	85%	85%	85%
Bruto prodhimi në stabilimentet prodhuese në Ngrohtore (MWh)	1,663	1,018	326	-	1,033	4,190	2,006	10,236
Bruto prodhimi në stabilimentet e kogjenerimit (nëse është e aplikueshme) (MWh)	2,976	2,688	2,976	1,235	-	-	2,976	12,851
Total bruto prodhimi i energjisë termike (MWh)	4,639	3,706	3,302	1,235	1,033	4,190	4,982	23,087
Humbjet sasiore në rrjetin e transportimit (nëse është e aplikueshme) (MWh)	0	0	0	0	0	0	0	0
Konsumi vetanak (MWh)	12.9	10.9	8.6	2.7	3.2	9.6	12.1	60
Neto prodhimi i energjisë termike (MWh)	4,626	3,695	3,293	1,232	1,030	4,180	4,970	23,027

Tabela 12. Përmbledhje e bilancit vjetorë energjisë termike për vitin 2025

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Vlera
1	Energjia nga lënda djegëse - Biomassë -Gedhendla druri	(MWh _{TH})	27,161
2	Efikasiteti termik i stabilimenteve prodhuese në Ngrohtore	(%)	85%
3	Prodhimi bruto i energjisë termike në Stabilimentet prodhuese të Ngrohtores	(MWh _{TH})	10,236
4	Prodhimi bruto i energjisë termike në stabilimentet e kogjenerimit	(MWh _{TH})	12,851
5	Total Bruto Prodhimi i energjisë termike	(MWh _{TH})	23,087
6	Humbjet sasiore në rrjetin e transportit (rrjetin e kogjenerimit)	(MWh _{TH})	0
7	Humbjet në përqindje në rrjetin e transportit	(%)	0.00%
8	Konsumi vetanak	(MWh _{TH})	60
9	Neto Prodhimi i energjisë termike / energjia termike e futur në rrjetin e shpërndarjes	(MWh _{TH})	23,027
10	Humbjet sasiore në rrjetin e shpërndarjes	(MWh _{TH})	3,454
11	Humbjet në përqindje në rrjetin e shpërndarjes	(%)	15.00%
12	Furnizimi me energji termike	(MWh _{TH})	19,573
13	Shpenzimi i lëndës djegëse	(ton)	10,416
14	Sipërfaqja ngohëse	m ²	156,800
15	Numri i nënstacioneve termike		353
16	Kapaciteti i instaluar prodhues	MW	15 (TH); 1.1 (EL)
17	Gjatësia e tubacionit të rrjetit	km	47.07

Planifikimi i Remonteve dhe Riparimeve

Pasi që është viti i katërt i instalimit të këtyre njësive të reja nuk është parashikuar ndonjë riparim apo remont i planifikuar. Por nëse paraqitet kërkesa për një remont mund të ndërmarrim masa gjithnjë sipas udhëzimeve të prodhuesit.

Impianti është dorëzuar në Korrik 2021. Në vitet në vazhdim do të parashikohen dhe zbatohen gjitha udhëzimet për mirëmbajtje dhe remonte periodike sipas udhëzimeve nga prodhuesi.

Emetimet e Parashikuara për Vitin Aktual

Emetimi i ndotësve të ajrit për impiantin e Ngrohtores së Qytetit Gjakovë për secilën njësi që prodhon energji me djegie të ashklave të drurit - Biomassës janë kalkuluar në tabelën vijuese. Këto janë emetimet të parashikuara të SO₂, NO_x dhe CO₂, në bazë të sasisë së energjisë që parashihet të prodhohet dhe koeficientit specifik të emetimit

Tabela 13. Emetimet e parashikuara për vitin 2025

EMETIMET E PARASHIKUARA PËR VITIN AKTUAL – VITI 2025						
Muajt	Prodhimi i energjisë termike	Pluhur	SO ₂	NO _x	CO ₂	Mbetjet e hirit (nëse e aplikueshme)
	MWh	t	t	t	t	t
Janar	4,639	0.23194	0.46388	2.3194	1.85552	30.1522
Shkurt	3,706	0.185305	0.37061	1.85305	1.48244	24.08965
Mars	3,302	0.165075	0.33015	1.65075	1.3206	21.45975
Prill	1,235	0.061755	0.12351	0.61755	0.49404	8.02815
Tetor	1,033	0.05166	0.10332	0.5166	0.41328	6.7158
Nëntor	4,190	0.20949	0.41898	2.0949	1.67592	27.2337
Dhjetor	4,982	0.24912	0.49824	2.4912	1.99296	32.3856
Total	23,087	1.154345	2.30869	11.54345	9.23476	150.06485
Për njësi	(kg/MWh)	0.00005	0.0001	0.0005	0.0004	0.0065